



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2018-01/IA002

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 1 nëntor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

### Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së Driton Lajçit:**

Tobi Kadman

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77, 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit pas lëshimit nga Gjykatësi i Vetëm të “Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00258” (“Vendimi për Miratimin e Lejes për Apel”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 3 tetor 2022, Gjykatësi i Vetëm lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>2</sup>
2. Më 10 tetor 2022, z. Driton Lajçi kërkoi leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.<sup>3</sup>
3. Më 31 tetor 2022, Gjykatësi i Vetëm lëshoi Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim, ku miratoi, pjesërisht, kërkesën e z. Lajçi për leje për apel.<sup>4</sup>

## II. KLASIFIKIMI

4. Vendimi për Miratimin e Lejes për Apelim është klasifikuar si konfidencial dhe, për

---

<sup>1</sup> F00267, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00258, 31 tetor 2022 (konfidencial).

<sup>2</sup> F00258, Vendim mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 3 tetor 2022 (konfidencial).

<sup>3</sup> F00261, Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit (KSC-BC-2018-01/F00258), 10 tetor 2022 (konfidenciale).

<sup>4</sup> Vendimi për Miratimin e Lejes për Apel, para. 33.

rrjedhojë, edhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

### III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

#### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin  
në pajtim me Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,  
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 1 tetor [si në origjinal] 2022  
Në Hagë,  
Holandë